* Mënyrë e nxehtës sipas klasës së efikasitetit të energjisë EN50304.

Pozitat	Funksioni
☐	Pjekje e rrafshët në skarë, sipërfaqe e madhe Me skarë mund të piqni më shumë steka, salsiçe, peshq dhe toste. E gjithë sipërfaqja nën nxehtësin e skarës nxehet
☐	Shkrirja Shembull mish, shpend, bukë dhe torta . Ventilatori e shpërndan ajrin e nxehtë përreth gjellës.


* Mënyrë e nxehtës sipas klasës së efikasitetit të energjisë EN50304.

Nëse është rregulluar mënyra e dëshiruar e nxehtës, llamba në furrë ndriçon.

Zgjedhësi i temperaturës

Me zgjedhësin e temperaturës mund ta rregulloni temperaturën dhe shkallën e skarës

Pozitat	Funksioni
●	Zero-pozicioni Furra nuk nxehet.
50-270	Zona e temperaturës Të dhënat e temperaturës në °C.
1, 2, 3	Shkallët e skarës Shkallët e skarës, për skarë me sipërfaqe, të vogël ☐ dhe të madhe ☐. Shkalla 1 = dobët Shkalla 2 = e mesme Shkalla 3 = e fortë

Gjatë kohës që furra nxehet, në tregues ndriçon  simboli i temperaturës. Nëse nxehtëja ndërpritet, simboli shuhet. Te disa rregullime ajo nuk ndriçon.

Butonat dhe treguesi

Me butonat mund të zgjidhen funksione të ndryshme plotësuese. Në tregues mund ti lexoni vlerat e rregulluara.

Butoni	Funksioni
⌚	Butoni orë Me këtë buton mund të rregullohen zgjuarësi dhe kohëzgjatja \rightarrow .
-	Butoni minus Me këtë buton mund të korrigjohen vlerat e rregullimit nga poshtë.
+	Butoni plus Me këtë buton mund të korrigjohen vlerat e rregullimit nga lartë.

Hapësira për zierje

Në hapësirën për zierje gjendet llamba e furrës. Një ventilator e mbron furrën nga stërnxehtëja.

Llamba e furrës

Gjatë punës në hapësirën për zierje llamba e furrës ndriçon.

Ventilatori ftohës

Ventilatori ndizet dhe fiket sipas nevojës. Ajri i ngrohtë del përmes derës.

Që hapësira për zierje pas punës më shpejtë të ftohet, ventilatori do të ecë për një kohë të caktuar më tej.

Kujdes!

Vrimën për ajrosje mos e mbuloni. Përndryshe furra do të stërnxehtë.


Pajisja e juaj

Pajisja e juaj e bashkëdërguar është e përshtatshme për shumë gjellë. Kini kujdes në atë, që pajisjen gjithmonë ta futni si duhet në hapësirën për zierje.

Që disa gjellë të bëhen më të mira ose manovrimi me furrën tuaj të re të bëhet akoma më i rehatshëm, ekziston një zgjidhje e pajisjeve të veçanta.


Futja e pajisjeve

Pajisjen mund ta futni në 5 lartësi të ndryshme në hapësirën për zierje. Futni gjithmonë deri në një goditje, ashtu që pajisja mos të vijë në kontakt me fletën e derës.



Pajisja mund të nxirret gati përgjysmë, derisa të rraset. Kështu gjellët nxirren më lehtë.

Gjatë futjes në hapësirën për zierje kini kujdes në atë, që brinja të jetë në anën e prapme të pajisjes. Vetëm kështu rraset siç duhet.



Udhëzim: Nëse pajisja nxehet mund të deforformet. Kur të ftohet përsëri, deformimi zhduket. Kjo nuk ka ndikim në funksion.

Mbani tepsinë në të dyja anët me të dy duart dhe futeni atë paralelisht në skarë. Gjatë futjes së tepsisë në furrë ikni lëvizjeve djathtas apo majtas. Ndryshe, tepsia vështirë mund të futet në furrë tepsia. Sipërfaqet e emaluara mund të dëmtohen.

Pajisjen mund ta bleni më pas te shërbimi për klientë, në dyqane të specializuara ose përmes internetit. Ju lutemi shënoni HEZ-Numrin.



Skara

Për enë, kallëpe ëmbëlsirash, mish i skuqur, copa mishi në skarë dhe gjellë të ngrira.

Skarën e futni në furrë me anën e hapur në drejtim të derës së furrës dhe me lakimin nga poshtë.



Tepsi e emaluar për pjekje

Për ëmbëlsira dhe gurabije.

Tepsinë për pjekje e futni në furrë me ngushtimin në drejtim të derës së furrës.

Pajisje të veçanta

Pajisjet e veçanta mund ti blini në shërbimin e klientëve ose në dyqanin e specializuar. Në broshurat tona ose në internet do të gjeni produkte të ndryshme adekuate për furrën tuaj.

Disponueshmëria e pajisjeve të veçanta ose mundësia e porositjes nëpërmjet internetit është e ndryshme nga vendi në vend. Informacione për këtë do të gjeni në dokumentet e shitjes.

Jo çdo pajisje e veçantë është adekuate për çdo aparat. Me rastin e blerjes gjithmonë jepni emrin e plotë (E-Nr.) e aparatit tuaj.

Pajisje të veçanta	Numri HEZ	Funksioni
Tepsia për pica	HEZ317000	E përshtatshme veçanërisht për pica, gjellë të ngrira dhe torte të rrumbullakëta. Tepsinë për pica mund ta përdorni si tigan universal. Tepsinë e futni mbi skarë dhe përmbahuni të dhënave në tabela.
Shosha	HEZ324000	Për skuqje. Skarën e vendosni gjithmonë në tiganin universal. Yndyra dhe lëngu i mishit që kullojnë do të mblidhen.
Tepsia për pjekje	HEZ325000	Përdoret gjatë pjekjes me skarë në vend të skarës ose si mbrojtës nga stërpikja, për ta mbrojtur furrën nga ndotjet e mëdha. Tepsinë për pjekje e përdoreni vetëm me tiganin universal. Copa mishi mbi tepsinë e skarës: Mund të përdoren në lartësitë e futjes 1, 2 dhe 3. Tepsinë për pjekje si mbrojtje nga spërkatja: Tigani universal futet së bashku me tepsinë e skarës nën skarë.
Guri për pjekje	HEZ327000	Guri për pjekje përshtatet shkëlqyeshëm për përgatitjen e bukëve të bëra vetë dhe pica, të cilat duhet të kenë pjesën e poshtme të brydhët. Guri për pjekje duhet përherë të ngrohet paraprakisht në temperaturën e sugjeruar.
Tepsi e emaluar për pjekje	HEZ331003	Për ëmbëlsira dhe gurabije. Tepsinë për pjekje e futni në furrë me ngushtimin në drejtim të derës së furrës.
Tepsi për pjekje e emaluar me shtresë kundër ngjitjes	HEZ331011	Ëmbëlsirat dhe gurabijet shpërndahen mirë në tepsinë për pjekje. Tepsinë për pjekje e futni në furrë me ngushtimin në drejtim të derës së furrës.

Pajisje të veçanta	Numri HEZ	Funksioni
Tigani universal	HEZ332003	Për ëmbëlsira të lëngshme, të pjekura, ushqime të ngrira dhe skuqje të mëdha. Mund të përdoret edhe nën skarë për mbledhjen e yndyrës ose lëngut të mishit. Tiganin universal e futni në furrë me ngushtimin në drejtim të derës së furrës.
Tigan universal me shtresë kundër ngjitjes	HEZ332011	Ëmbëlsirat e lëngshme, të pjekurat, gjellët e ngrira dhe skuqjet e mëdha shpërndahen mirë në tiganin universal. Tiganin universal e futni në furrë me ngushtimin në drejtim të derës së furrës.
Kapaku për tiganin profesional	HEZ333001	Me kapak tiganin profesional bëhet skuqës profesional.
Tigani profesional me shoshë	HEZ333003	Është veçanërisht i përshtatshëm për përgatitjen e sasive të mëdha.
Skarë	HEZ334000	Për enë, kallëpe ëmbëlsirash, mish i skuqur, copa mishi në skarë dhe gjellëza të ngrira.
Pjekës nga xhami	HEZ915001	Skuqësi i qelqtë është i përshtatshëm për gjellë të kaurdisura dhe tava. Është veçanërisht i përshtatshëm për programet dhe automatikën e skuqjes.

Artikulli-shërbimi i klientëve

Për pajisjet tuaja shtëpiake mund ti bleni më pas mjetet për mirëmbajtje dhe pastrim ose pajisje shtesë te shërbimi i

klientëve, dyqanet e specializuara ose përmes internetit për shtete të veçanta në e-Shop. Shënoni Numrin përkatës të artikullit gjatë porositjes ose blerjes.

Riza për mirëmbajtje të sipërfaqeve nga çeliku	Artikel-Nr. 311134	Reduktimi i shtresimit të papastërtisë. Me mbrojtjen me vajra speciale sipërfaqet e pajisjeve me çelik do të mirëmbahen në mënyrë optimale.
Xhel për pastrim të furrës- të rostos	Artikel-Nr. 463582	Për pastrimin e hapësirës së zierjes me avull. Xheli nuk mban erë
Rizë mikrofiber me struktur të thurur	Artikel-Nr. 460770	Posaçërisht i përshtatshëm për pastrimin e sipërfaqeve të ndjeshme, si p. sh. qelqi, qeramik qelqi, çeliku ose alumini. Riza mikrofiber i mënjanon me një dorë papastërtitë e lëngshme dhe të yndyrshme.
Sigurimi i derës	Artikel-Nr. 612594	Për të mos e hapur fëmijët derën e furrës. Siguresa është e vidhosur ndryshe varësisht nga dera e pajisjes. Shikoni dokumentacionin shtesë, në siguresën e derës.

Para përdorimit të parë

Këtu mësoni se çfarë duhet bërë, para se të përgatitni ushqim për herë të parë në furrë ose në pllakat e zierjes me gas. Lexoni së pari kapitullin *Udhëzime mbi sigurinë*.

Rregullimi i kohës së orës

Pas lidhjes së parë në tregues ndriçon simboli \rightarrow .

1. Sigurohuni që, simboli \rightarrow në tregues të xixëllojë.

2. Butonin \odot e shtypni.
Treguesi errësohet.

Furra tash është gati për punë.

Nxehja e furrës

Për ta larguar kundërmimin nga e reja, nxehni furrën e zbrazur dhe të mbyllur. Ideale për këtë është një orë me nxehësin e epërm-/të poshtëm \square me 240 °C. Kini kujdes në atë, që në hapësirën për zierje mos të ketë mbetje nga paketimi.

1. Me zgjedhësin e funksioneve rregulloni nxehësin e epërm-/të poshtëm \square .

2. Me zgjedhësin e temperaturës rregulloni në 240 °C.

Pas një ore furrën e fikni. Zgjedhësin e funksioneve dhe Zgjedhësin e temperaturës e rrotulloni në pozicionin zero.

Nxehja e pllakës nxehëse

Për ta mënjanuar kundërmimin nga e reja, pllakën nxehëse e nxehni pa tenxhere në shkallën më të lartë për 3 minuta gjatë.

Pastrimi i pajisjeve shtesë


Para se ta përdorni pajisjen shtesë për herë të parë, pastroni atë mirë me mjet larës dhe me rizë të butë për pastrim.

Para-pastrimi i kupës dhe kapakut të djegësit

Pastroni Kupën e djegësit (1) dhe Kapakun e djegësit (2) me ujë dhe detergjent. Pjesët e veçanta i thani me kujdes.

Kupën dhe kapakun e djegësit e vendosni përsëri në tasin e djegësit (5). Gjatë kësaj duhet të kihet kujdes, që ndezësi (3) dhe lapsi mbrojtës i flakës (4) mos të dëmtohen.

Pipthi (6) duhet të jetë i thatë dhe i pastër. Vendosni kapakun e djegësit gjithmonë saktë mbi kupën e djegësit.



Ena e përshtatshme për zierje



Djegësi/pllaka nxehtëse elektrike	Diametri minimal i tenxheres	Diametri maksimal i tenxheres
Pllaka nxehtëse elektrike*	14,5 cm	14,5 cm
Djegës Wok** 3,6 kW	24 cm	28 cm
Djegësi me kursim 3kW	24 cm	28 cm
Djegësi normal 1,7 kW	18 cm	24 cm
Djegësi me kursim 1kW	12 cm	18 cm

* Opsioni (për modelet me pllaka nxehtëse elektrike)

** Opsioni (për modelet me djegës Wok)



Udhëzime gjatë përdorimit

Udhëzimet e mëposhtme do të ju ndihmojnë, të kurseni energji dhe ti parandaloni dëmtimet në enët për zierje:





Përdorni enë për zierje me madhësi të përshtatshme për djegësin përkatës.

Mos përdorni enë të vogla për zierje në djegësit e mëdhenj. Flaka nuk lejohet ti prekë anët e enës për zierje.





Mos përdorni enë për zierje të deformuara, të cilat nuk qëndrojnë stabile në zonën e zierjes. Enët mund të përmbysen.



Përdorni vetëm enë për zierje me fund të rrafshët dhe të trashë.



Mos zieni pa kapak ose me kapak të zhvendosur. Një pjesë e madhe e energjisë do të humbet.




Vendoseni enën gjithmonë në qendër të djegësit, përndryshe ka rrezik të rrëzohet.




Tenxheret vendosni gjithmonë në skara, asnjëherë direkt në djegës.

Para përdorimit sigurohuni, që skarat e tenxheres dhe kapakët e djegësit të gazit të flenë në mënyrë korrekte.



Veproni me kujdes me enët për zierje, të cilat qëndrojnë mbi zonën e zierjes.

Mos goditni mbi zonën e zierjes dhe mos vendosni pesha të rënda mbi te.



Mos përdorni dy djegës ose burime nxehtësie për një enë gatimi.

Shmangni përdorimin e tiganëve për skuqje, enëve të baltës për një kohë të gjatë me fuqi maksimale.


Rregullimi i zonës për zierje

Zona e juaj e zierjes është e pajisur me tre djegës gazi dhe një pllakë nxehtë. Këtu mund të lexoni se si ta ndizni djegësin e gazit dhe si ta rregulloni pllakën nxehtë.

Ndezja e djegësit të gazit

Vendosni kapakun e djegësit gjithmonë saktë mbi kupën e djegësit. Vrimat në kupën e djegësit gjithmonë duhet të jenë të lira. Të gjitha pjesët duhet të jenë të thata.

1. Hapni mbulesën e epërme. Derisa shporeti është duke punuar, mbulesa e epërme duhet të jetë e hapur.
2. Ndërprerësin e pllakës nxehtë të dëshiruar e rrotulloni majtas në pozicionin ndezës ✨. Ndezja fillon.
3. Shtypni ndërprerësin e pllakës nxehtë dhe mbajeni atë të shtypur për 1-3 sekonda. Djegësi i gazit ndizet.



Do të aktivizohet siguresa e ndezjes. Nëse flaka e gazit fiket, furnizimi me gaz do të ndërpritet automatikisht, nëpërmjet sistemit të siguresës së ndezjes.

4. Rregulloni madhësinë e dëshiruar të flakës. Mes rregullimit ¹ i fikur dhe rregullimit ² flaka nuk është stabile. Prandaj gjithmonë zgjidhni një rregullim mes ² flakë e madhe dhe ¹ flakë e vogël.
5. Nëse flaka sërish fiket, përsëritni procesin prej hapit 2.
6. Përfundimi i procesit të zierjes: Rrotulloni ndërprerësin e pllakës nxehtë ³ djathtas në pozicionin fikur.

Mekanizmi ndezës nuk duhet të vihet në punë më gjatë se 15 sekonda. Nëse djegësi pas 15 sekondash nuk ndizet, pritni më së paku një minutë. Pastaj përsëritni procedurën e ndezjes.

⚠️ Kujdes!

Nëse pas fikjes në shporetin akoma të nxehtë e rrotulloni ndërprerësin e pllakës nxehtë, del gaz. +Nëse ndërprerësin nuk e vendosni në pozicionin ndezës ✨, furnizimi me gaz pas 60 sekondave do të ndërpritet.

Djegësi i gazit nuk ndizet.

Gjatë rënies së rrymës elektrike apo kur kandela për ndezje është e lagët, djegësin e gazit mund ta ndizni me fije shkrepe.

Kështu e rregulloni pllakën nxehtë elektrike

Me ndërprerësit e pllakave nxehtë mund ta rregulloni kapacitetin e pllakave nxehtë.

Procedura

1. Hapeni kapakun e epërme. Derisa pllaka nxehtë elektrike është duke punuar, mbulesa e epërme duhet të jetë e hapur.
2. Ndërprerësin e pllakës nxehtë elektrike e rrotulloni majtas në një shkallë adekuatë të zierje ndërmjet 1-6.
3. Diametri i pllakës nxehtë elektrike është 145 mm. Për të zier përdorni një tenxhere me fund të rrafshët dhe diametër të njëjtë.
4. Për ta përfunduar procesin e zierjes, ndërprerësin e pllakës nxehtë elektrike e vendosni në 0.

Shkalla e zierjes 1 = kapacitet më i vogël

Shkalla e zierjes 6 = kapacitet më i madh

Mënyrë e nxehtës	1 ose 2	në varësi të sasisë
Zierja	6 2	Fillimi i procesit të zierjes Procesin e zierjes e vazhdoni më tej, sipas nevojës lartë ose ulët
Pjekja në skarë	6 4	Nxehtëja e vajit, Fillimi i procesit të pjekjes me skarë Vazhdimi i pjekjes me skarë

Kur pllaka nxehtë ndizet, llamba treguese ndriçon.

Informacione të rëndësishme për pllakën tuaj nxehtë elektrike

Nëse diametri i tenxheres ose fundi e tiganit nuk përputhet me pllakën nxehtë ose nëse fundi i tiganit nuk është i rrafshët do të harxhohet pa nevojë energji. Të derdhurat digjen dhe lënë pas njolla që vështirë largohen.

Kini kujdes që, fundi i tenxheres ose tiganit të jetë gjithmonë i thatë.

Pllaka nxehtë elektrike nuk duhet të ndizet nëse mbi të nuk ka tenxhere.

Për shkak të ndikimit të ngrohtësisë unaza e pllakave nxehtë me kalimin e kohës e ndryshon ngjyrën. Ndryshimin e ngjyrës mund ta eliminoni, ashtu që unazën e pllakës nxehtë e pastroni me mjet për pastrim me anën e vrazhdë të sfungjerit. Gjatë pastrimit kini kujdes në atë që, që sfungjeri mos të vijë në kontakt me pllakën nxehtë.

Pas fikjes së pllakës nxehtë ka akoma ngrohtësi të mbetur. Fëmijët i mbani larg aparatit.

Sigurohuni, që butoni rrotullues i pllakës nxehtë pas një ndërprerje të rrymës të jetë i fikur.

Tabela - zierja

Për çdo pllakë zgjidhni madhësinë e duhur të tenxheres. Rrezja e fundit të tenxheres ose e tiganit duhet të korrespondoj me madhësinë e pllakës për zierje.

Kohët e zierjes varen nga lloji, pesha dhe cilësia e ushqimeve. Prandaj mund të ketë përjashtime. Kohët e përshtatshme të zierjes do të mundeni vet ti parashikoni.

Përmbajtjet e mineraleve dhe vitaminave gjatë zierjes shkatërrohen shpejtë. Prandaj përdorni vetëm pak ujë. Në këtë mënyrë vitaminat dhe mineralet do të ruhen. Zgjidhni kohë të shkurtra të zierjes, që perimet të ngelin më të freskëta dhe me përmbajtje ushqimore.

Shembull	Gjella	Pllakë nxehtë	Shkalla e zierjes
Shkrirja	Çokollatë, gjalpë, margarinë	Djegësi kursyes	flakë e vogël
Ngrohja	Çorbë, perime në konservë	Djegësi normal Pllaka nxehtë elektrike	flakë e vogël 1-2
Ngrohja dhe mbajtja ngrohtë	Supëzat	Djegësi kursyes Pllaka nxehtë elektrike	flakë e vogël 1-2
Avullimi*	Peshk	Djegësi normal Pllaka nxehtë elektrike	ndërmjet flakës së vogël dhe të madhe 3-4
Avullimi*	Patate dhe perime të tjera, peshk	Djegësi normal Pllaka nxehtë elektrike	ndërmjet flakës së vogël dhe të madhe 3-4
Zierja*	Oriz, perime, ushqime me mish (me salcë)	Djegësi normal Pllaka nxehtë elektrike	lartësi e madhe e flakës 5-6
Skuqja	Petulla, patate, copë mishi, shkopinj peshku	Djegës i fortë	ndërmjet flakës së vogël dhe të madhe

* Nëse përdorni një tenxhere me kapak, porsa të ziej, flakën rrotullojeni prapa.


Regullimi i furrës

Ju keni mundësi të ndryshme për të bërë rregullimin e furrës suaj. Këtu do të ju sqarojmë, se si ta rregulloni mënyrën e dëshiruar të nxehtësisë dhe temperaturën ose shkallën e skarës. Mund që për gjellën tuaj ta rregulloni kohëzgjatjen dhe kohën e përfundimtare në furrë.


Mënyrat e nxehtësisë dhe temperatura

Shembull në fotografi: 190 °C, Nxehtësi i epërm-/i poshtëm

1. Me zgjedhësin e funksioneve e rregulloni mënyrën e dëshiruar të nxehtësisë.



2. Me zgjedhësin e temperaturës mund ta rregulloni temperaturën ose shkallën e skarës



Furra do të nxehet.

Fikja e furrës

Rrotulloni çelësin e funksionit në pozicionin zero.

Ndryshoni konfigurimet


Llojin e ngrohjes dhe nivelin e temperaturës ose skarës mund ta ndryshoni në çdo kohë me çelësin përkatës.

Fikja automatike e furrës

Jepni një kohë zierje për gjellën tuaj.

Shembull në fotografinë: Nxehtësi i epërm-/i poshtëm , 200 °C, kohëzgjatja 45 minuta.

1. Me zgjedhësin e funksioneve e rregulloni mënyrën e dëshiruar të nxehtësisë.
2. Me zgjedhësin e temperaturës mund ta rregulloni temperaturën ose shkallën e skarës
3. Butonin orë e shtypni dy herë. Simboli kohëzgjatja i xixëllon.



4. Me butonin + ose - e rregulloni kohëzgjatjen. Butoni + / vlera e rekomanduar = 30 minuta
Butoni - / vlera e rekomanduar = 10 minuta



Furra pas disa sekondave starton. Në tregues shkëlqen simboli .

Koha e zierjes ka mbaruar

Një sinjal tingëllon. Furra fiket. Butonin e shtypni dy herë dhe e fikni zgjedhësin e funksioneve.

Ndërprerja e parakohshme e rregullimit

Butonin orë ⌚ e shtypni dy herë. Butonin - e shtypni, derisa në tregues të shkëlqejë një zero. Fikja e zgjedhësit të funksioneve.

Ndërrimi i rregullimit

Butonin orë ⌚ e shtypni dy herë dhe rregulloni siç është përshkruar në kapitullin 4.

Udhëzim: Rregullimin mund ta ndërroni përderisa simboli xixëllon. Kur simboli ndriçon, rregullimi është pranuar.

Rregullimi i zgjuarësit

Zgjuarësin mund ta përdorni si një zgjuarës kuzhine. Ai ecë pavarësisht nga furra. Zgjuarësi ka një sinjal të veçantë. Me këtë mund të dëgjoni, kur koha e zgjuarësit ose kohëzgjatja ka mbaruar.

Kështu rregulloni

1. Butonin orë ⌚ e shtypni.
Simboli zgjuarës 🔔 xixëllon.
2. Me butonin + ose - e rregulloni kohën e zgjuarësit.
Butoni + / vlera e rekomanduar = 10 minuta
Butoni - / vlera e rekomanduar = 5 minuta

Pas disa sekondave zgjuarësi starton. Në tregues shkëlqen simboli 🔔. Koha e mbaruar do të tregohet.

Koha ka mbaruar

Një sinjal tingëllon. Butonin orë ⌚ e shtypni. Treguesi i zgjuarësit shuhet.

Ndërrimi i kohës së zgjuarësit

Butonin orë ⌚ e shtypni. Me butonin + ose - mund ta ndërroni kohën.

Shuarja e rregullimit

Butonin orë ⌚ e shtypni. Butonin - e shtypni aq shpesh, derisa në tregues të shkëlqejë një zero.

Zgjuarësi dhe kohëzgjatja mbarojnë në të njëjtën kohë

Simbolet ndriçojnë. Koha e zgjuarësit në tregues ecë dukshëm. Testimi i kohëzgjatjes së mbetur I→II:
Butonin orë ⌚ e shtypni dy herë.
Vlera e testuar shkëlqen për disa sekonda në tregues.

Mirëmbajtja dhe pastrimi

Me mirëmbajtje të kujdeshme dhe pastrim të mirë shporet dhe furra qëndrojnë bukur dhe funksionale shumë gjatë. Se si ti mirëmbani dhe ti pastroni iu sqarojmë këtu.

Udhëzime


- Dallimet e vogla të ngjyrës në pjesën e përparme të shporetit rezultojnë nga materiallet e ndryshme, qelqi, plastika ose metali.
- Hijet në xhamin e derës, që duken si jargë, janë reflekshe të dritës nga llamba e furrës.
- Emali mund të digjet së bashku nga temperaturat shumë të larta. Kështu mund të ndodh të shfaqen dallime të vogla të ngjyrës. Kjo gjë është normale dhe nuk ka asnjë ndikim mbi funksionalitetin. Këndet e teneqeve të holla nuk mund të emajlohen deri në fund. Për këtë arsye mund të jenë të vrazhda. Por nga kjo nuk rrizikohet mbrojtja nga korozioni.

Mbulesa e epërme e qelqtë

Para se ta hapni mbulesën e epërme, hiqni eventualisht gjërat e derdhura me një leckë.

Për pastrim më së miri përdorni një pastrues qelqi.

Për ta pastruar hiqni mbulesën e epërme. Për këtë mbulesën e kapni fortë me të dy duart anash dhe e tërhiqni nga lartë.



Nëse menteshat e mbulesës lirohen, kini kujdes shkronjat që gjenden në to. Mentështa me shkronjën R duhet të montohet në

anën e djathtë, mentështa me shkronjën L të montohet në anën e majtë.

Pas pastrimit, mbulesën e epërme e montoni përsëri në radhë të kundërt.

Mbulesën e epërme e mbyllni tek atëherë, kur pllakat nxehtë të jenë ftohur.

Mjet për pastrim

Me qëllim që sipërfaqet e ndryshme të mos dëmtohen nga lëndët e ndryshme pastruese, merrni parasysh të dhënat në vijim.

Gjatë pastrimit të zonës së zierjes

- mos përdorni as lëndë pastruese të paholluara ose lëndë pastruese për pjatarëse,
- as sfungjerë për fërkim,
- as lëndë pastruese agresive, si lëndë pastruese për furrë apo mënjanes të njollave,
- as pastrues me presion të lartë ose pastrues me avull.
- Pjesët e veçanta të mos pastrohen në pjatarëse.

Gjatë pastrimit të furrës

- kurrfarë lëndësh të ashpra apo fërkuese për pastrim,
- kurrfarë lëndësh pastruese me përqindje të lartë të alkoolit,
- as sfungjerë për fërkim,
- as pastrues me presion të lartë ose pastrues me avull.
- Pjesët e veçanta të mos pastrohen në pjatarëse.

Sfungjerët e ri i lani mirë para përdorimit të parë.


Pjesa e përparme me hekur të fisnikëruar	Fshini me pak lëndë pastrimi dhe një leckë të lagët. Fshini gjithmonë paralel me strukturën natyrale. Përndryshe mund të shkaktohen gërvishtje. Thani me një leckë të butë. Njollat e gëlqeres, yndyrës, të përlyerjes nga ushqimi dhe të bardhës së vesë i largoni menjëherë. Mos përdorni mjete për fërkim, sfungjerë që gërvishtin apo lecka të vrazhda për pastrim. Pjesët e përparme të hekurit të fisnikëruar mund t'i lustroni me ndihmën e një lënde speciale për mirëmbajtje. Shikoni udhëzimet e prodhuesit. Pastruesin special të hekurit të fisnikëruar mund ta merrni pranë shërbimit tonë të klientëve ose në treg.
sipërfaqet e emaluara dhe ato të lyera me llak	Fshini me pak lëndë pastrimi dhe një leckë të lagët. Thani me një leckë të butë.
Djegësi dhe grila e çeliktë e vendit për zierje me gaz	Mos i pastroni në pjatlarëse. Nxirrni skarën dhe pastroni atë me një sfungjer, lëndë pastrimi dhe me pak ujë të ngrrohtë. Hiqni kupën dhe kapakun e djegësit. Për pastrim përdorni një sfungjer me pak ujë të ngrrohtë dhe lëndë pastrimi. Kini kujdes, që hapjet e daljes së gazit në kupën e djegësit të jenë të pastra dhe të mos jenë të mbyllura. Ndezëset të pastrohen me një brushë të vogël dhe të butë. Djegësit funksionojnë vetëm nëse ndezëset janë të pastra. Mbetjet nga ushqimi të hiqen nga kapaku u djegësit me pak lëndë pastrimi dhe me një leckë të butë. Gjatë kësaj përdorni vetëm pak ujë. Uji nuk guxon të depërtojë në brendi të aparatit. Kini kujdes, që hapjet e pipëzave gjatë pastrimit të mos mbyllen ose të dëmtohen. Pas pastrimit, të gjitha pjesët të thahen dhe kapakun e djegësit vendosni saktë mbi kupën e djegësit. Nëse pjesët nuk vendosen saktë, do të vështirësohet ndezja e djegësit. Kapakët e djegësit janë të emaluara me një shtresë të zezë. Në bazë të temperaturave të larta mund të vijë deri të ndryshimi i ngjyrës. Kështu do të zvogëlohet funksioni i djegësit. Skarën përsëri vendoseni në furrë.
Pllaka nxehtë elektrike (zgjedhje)	Pastroni me anën e fortë të sfungjerit për fërkim dhe pak lëndë të lëngshme për fërkim. Pas pastrimit, pllaka nxehtë të kyçet shkurt për tu tharë. Pllakat e lagëta me kalimin e kohës ndryshken. Në fund vini lëndë për mirëmbajtje. Menjëherë hiqni lëngjet e derdhura dhe mbetjet e ushqimit.
Unaza metalike e pllakës nxehtë elektrike (zgjedhje)	Unaza metalike me kalimin e kohës mund ta ndryshojë ngjyrën. Ngjyra parapake mund të përtërihet. Pastroni unazën me anën e fortë të sfungjerit për fërkim dhe pak lëndë të lëngshme pastrimi lëndë të lëngshme fërkimi. Kini kujdes gjatë kësaj, që sipërfaqet fqinje të mos fërkohen. Këto sipërfaqe mund të dëmtohen.
Sustat	Fshini me pak lëndë pastrimi dhe një leckë të lagët. Thani me një leckë të butë.
Qelqi i derës	Mund të pastrohet me një pastrues qelqi. Mos përdorni lëndë agresive pastrimi apo sende të mprehta metalike. Këto mund ta gërvishtin dhe dëmtojnë sipërfaqen e qelqit.
Shtupës	Të fshihet me një leckë të butë. Thani me një leckë të butë.
Pjesa e brendshme e furrës	Pastroni me ujë të ngrrohtë apo ujë me uthull. Kur ka ndotje të mëdha: Lënda e pastrimit për furrë të përdoret vetëm në sipërfaqet e ftohura.
Mbulesa e qelqtë e llambës së furrës	Fshini me pak lëndë pastrimi dhe një leckë të lagët. Thani me një leckë të butë.
Pajisje	Zbutni në shumë detergjenti. Pastroni me një brushë ose me një sfungjer.
Tepsi alumini (zgjedhje)	Mos i pastroni në pjatlarëse. Asnjëherë mos përdorni lëndë pastrimi për furrë. Me qëllim tu shmangemi gërvishtjeve, asnjëherë mos i prekni sipërfaqet metalike me thikë apo me ndonjë send të fortë. Fshini me shumë detergjenti dhe një leckë të butë dritaresh ose me një leckë me mikrofiqe pa push, horizontalisht dhe pa shtypje mbi sipërfaqet. Thani me një leckë të butë. Mos përdorni mjete për fërkim, sfungjerë që gërvishtin apo lecka të vrazhda për pastrim. Ata e gërvishtin tepsinë
Pajisja për sigurinë e fëmijëve (zgjedhje)	Nëse është e vendosur një pajisje për sigurinë e fëmijëve, ajo duhet të hiqet para pastrimit. Të gjitha pjesët prej plastike të zbuten në shumë të ngrrohtë prej detergjenti dhe të fshihen me sfungjer. Thani me një leckë të butë. Kur është shumë e ndotur, pajisja për sigurinë e fëmijëve nuk funksionon më si duhet.
Sirtari i poshtëm (zgjedhje)	Fshini me pak lëndë pastrimi dhe një leckë të lagët. Thani me një leckë të butë.
Pajisje	Zbutni në shumë detergjenti. Pastroni me një brushë ose me një sfungjer.

Montimi dhe çmontimi i kornizës

Për pastrim mund ta heqni kornizën. Furra duhet të jetë e ftohur.

Zhvarja e mbështetësit:


1. Mbështetësin e nxirrni poshtë dhe e tërhiqni pak nga para. Kunjat vazhdues që gjenden në zonën e poshtme të mbështetësit i nxirrni jashtë nga vrimat përforcuese (Pasqyrimi A).
2. Në fund mbështetësin e palosni lartë dhe me kujdes e nxirrni (Pasqyrimi B).



Pastroni kornizën me mjet pastrues dhe me sfungjer për shpëlarje. Për ndotje të forta përdorni brushë për ta pastruar.


Varja e mbështetësit

1. Të dy grepat i vendosni në vrimat e epërme. (Pasqyrimi A-B)




⚠ Montimi i gabuar!

Aparatin mos e lëvizni asnjëherë, deri sa të dy grepat të mos jenë ancoruar në vrimat e epërme. Emali mund të dëmtohet dhe thyhet (Pasqyrimi C).



2. Të dy grepat duhet të jenë varur plotësisht në vrimat e epërme. Tani mbështetësin e lëvizni ngadalë dhe me kujdes nga poshtë dhe e varni në vrimat e poshtme (Pasqyrimi D).
3. Të dy mbështetësit i varni në muret anësore të furrës (Pasqyrimi E).


Kur mbështetësit të jenë montuar siç duhet distanca ndërmjet dy lartësive të epërme të futjes është më e madhe.



Montimi dhe çmontimi i derës së furrës

Për ta pastruar dhe për të hequr disqet e vogla të derës dera e furrës mund të çmontohet.

Nyjet e derës së shporetit kanë një levë mbyllëse. Nëse levët mbyllëse janë të palosura (Fotografia A), dera është e siguruar. Atëherë nuk mund të çmontohet. Nëse nyjet e derës janë të çpalosura për çmontimin e derës së furrës (Fotografia B), levët mbyllëse janë të siguruar. Ata nuk mund të klikojnë.




⚠ Rrizik nga lëndimi!

Nëse levët mbyllëse nuk janë të siguruar, palosni ata me më tepër forcë. Mbani llogari, që levët mbyllëse të jenë gjimon të palosura deri në fund, respektivisht gjatë çmontimit të jenë krejtësisht të çpalosura.

Nxirr derën

1. Derën e furrës e hapni plotësisht.
2. Shpallos të dy levët për mbyllje, në të djathtë dhe në të majtë (Fotografia A).
3. Mbyll derën e furrës deri në fund. Kape me të dy duart majtas dhe djathtas. Mbylle edhe më tej dhe nxirre (Fotografia B).




Montimi i derës


Dera e furrës montohet sipas udhëzimeve por në rënditje të kundërt.

1. Gjatë montimit të derës së furrës të kini kujdesë, që të jenë të vendosura të dy nyjet në hapjet përkatëse si në (Fotografia A).

2. Nivelet duhet të jenë të njëjta nga të dyja anët (Fotografia B).



3. Të dy levët mbyllëse sërish të palosen (Fotografia C). Mbyllja e derës së furrës



⚠ Rrizik nga lëndimi!


Nëse dera e furrës bie pa qëllim ose është çpalosur një levë, mos prekni gjë. Thirni shërbimin e klientëve.

Montimi dhe çmontimi fletëve të derës


Për pastrim më të mirë fletët e qelqit në derën e furrës mund ti çmontoni.

Çmontimi

1. Derën e furrës e varni dhe me dorezën nga poshtë e vendosni në një leckë.
2. Mbulesën lartë të derës së furrës e hiqni. Për këtë gjuhëzën e shtypni me gishta majtas dhe djathtas (Fotografia A).
3. Fletën e epërme e ngreni dhe e hiqni (Fotografia B).



4. Fletën e ngreni dhe e hiqni (Fotografia C).



Fletët i pastroni me pastrues qelqi dhe me një leckë të butë.


⚠ Rrezik nga lëndimi!

Qelqi i gërvishtur i derës së aparatit mund të pëlcasë. Mos përdorni kruese qelqi, mjete të sërta ose fërkuese për pastrim.

Montimi

Gjatë montimit kini kujdes, që mbishkrimi "right above" majtas poshtë të qëndrojë në kokë.

1. Fletën e futni pjerrtas nga prapa (Fotografia A).
2. Fletën e epërme e futni pjerrtas nga prapa në të dy mbajtësit. Sipërfaqja e lëmuar duhet të jetë jashtë. (Fotografia B).



3. Vendosni mbulesën dhe e shtypni.

4. Varja e derës së furrës.

Furrën do ta përdorni përsëri, kur fletët të jenë montuar si duhet.

Një pengesë, çfarë duhet bërë?

Nëse paraqitet një pengesë, shpeshë herë ndodh të jetë diçka e vogël. Para se të thini shërbimin e klientëve, shikoni së pari tabelën. Ndoshta do ta mënjanoni pengesën vetë.

Tabela e pengesave

Nëse gjella nuk bëhet në mënyrë optimale, shihni ju lutemi në kapitullin *për ju të testuara në studion tonë të gatimit*. Atje do të gjeni shumë këshilla dhe udhëzime për gatim.

Rrezik nga goditja e rrymës!

Riparimet e gabuara janë të rrezikshme. Riparimin guxon ta bëjë vetëm një teknik i shkolluar në shërbimin tonë të klientëve

Siguresa në arkën e siguresave në defekt.	Shkaqet e mundshme	Ndihmë/Udhëzime
Furra nuk funksionon.	Siguresa është në defekt. Rënie e rrymës.	Kontrolloni në arkën e siguresave, nëse siguresa është në rregull. Kontrolloni nëse, drita e kuzhinës ose aparatet e tjera të kuzhinës funksionojnë.
Treguesi i orës xixëllon.	Rënie e rrymës.	Rregullojeni sërish kohën e orës.
Furra nuk nxehet.	Në kontakte ka pluhur.	Rrotulloni më shumë herë andej këndeje dorëzat e ndërprerësve.
Djegësi i gazit nuk ndizet.	Rënie e rrymës ose kandilat nderzës të lagur.	Djegësin e gazit e ndizni me një nderzës të gazit ose me një shkrepës.


Ndërrimi i llambës së furrës në mbulesë

Nëse llamba e furrës është djegur, atëherë duhet të ndërrohet. Llambat për ndërrim rezistente ndaj temperaturës, 40 Vat, do ti gjeni te shërbimi i klientëve ose në shitoret e specializuara. Përdorni vetëm këto llamba.

Rrezik nga goditja e rrymës!

Fikni siguresën në arkën e siguresave.

1. Për të shmangur dëmtimet, vendosni në furrën e ftohtë leckën e enëve.
2. Hiqni mbulesën e qelqtë duke rrotulluar në të majtë.



3. Llambën e ndërroni me llambë të njëjtit tip.
4. Mbulesën e qelqtë e vidhosni përsëri.
5. Leckën e kuzhinës e nxirrni dhe siguresën e ndizni.

Mbulesa e qelqtë

Mbulesa e qelqtë e dëmtuar duhet të ndërrohet. Mbulesat përkatëse të qelqit do ti gjeni në shërbimin e klientëve. Shënoni E-Numrin dhe FD-Numrin të pajisjes tuaj.

Shërbimi i klientëve

Nëse pajisja juaj duhet të riparohet, shërbimi jonë për klientët qëndron në dispozicionin tuaj. Ne gjithmon gjejm një zgjidhje të përshtatshme, gjithashtu për të evituar vizita të panevojshme nga ana e teknikut.

E-numri dhe FD- numri

Gjatë thirrjes jepni numrin e prodhimit (E-Nr.) dhe numrin e ekzekutimit (FD-Nr.), që të mund të kujdesemi profesionalisht për ju. Etiketën e tipit me numrat e gjeni, anash në derën e furrës. Që në rast nevojë mos të kërkonti gjatë, këtu mund t'i bartni të dhënat e aparatit tuaj dhe numrat e telefonit të shërbimit të klientëve.

E-Nr.	FD-Nr.

Shërbimi i klientëve

Kini kujdes, se vizita e teknikut të servisit në rast të përdorimit të gabuar edhe brenda kohës së garancisë nuk është pa kosto.

Të dhënat e kontaktit për të gjitha vendet i gjeni në listën e përmbajtjes të shërbimit të klientëve.

Kini besim te kompetenca e prodhuesit. Kështu mund të jeni të sigurt se riparimin do ta realizojnë teknikët e trajnuar për riparim, të cilët janë të pajisur me pjesë këmbimi origjinale për pajisjet tuaja.

Këshilla mbi energjinë dhe mjedisin jetësor

Këtu mund të merrni këshilla, se si mund të kurseni energji gjatë pjekjes në furrë dhe të zieni mbi shporet dhe gjithashtu mbi mënyrën e vërtetë e hudhjes së shporetit.

Kursimi i energjisë në furrë

- Furrën e paranxehni vetëm atëherë, kur kështu është dhënë në recetë ose në tabelën e udhëzimit për përdorim.
- Përdorni kallëpe të errëta për pjekje, të lyera me llak të zi apo të emaluara. Ata e thithin nxehtësinë në mënyrë të veçantë.
- Gjatë zierjes, skuqjes ose pjekjes, derën e furrës e hapni sa më rrallë që është e mundur.
- Më shumë ëmbëlsira më së miri i piqni njëra pas tjetrës. Furra është ende e nxehtë. Me këtë shkurtohet kohëzgjatja e pjekjes për ëmbëlsirën e dytë. Mund të futni gjithashtu 2 kallëpe kuti pranë njëri tjetrit.
- Te kohët më të gjata të zierjes furrën mund ta fikni 10 minuta para përfundimit të kohës për zierje dhe ngrohtësinë e mbetur ta shfrytëzoni për mbarimin e plotë të zierjes.

Kursimi i energjisë në zonën e zierjes me gaz

- Zgjidhni gjithmonë një tenxhere me madhësinë e përshtatshme për gjellët tuaja. Tenxherja e madhe, vetëm pak e mbushur ka nevojë për shumë energji.
- Tenxheren e mbyllni gjithmonë me një kapak të përshtatshëm.
- Flaka e gazit duhet gjithmonë të ketë kontakt me fundin e tenxheres.

Hedhja sipas normave ekologjike

Hidheni paketimin sipas normave ekologjike.



Ky aparat përmban shënjën e aparaturave elektrike dhe elektroteknike sipas Udhëzimit 2012/19/EU (waste electrical and electronic equipment - WEEE).

Udhëzimi jep kuadrin ligjor për te drejtën e kthimit mbrapsht të aparaturave të përdorura në të gjithë BE.

Për ju të testuara në studion tonë të gatimit

Këtu do të gjeni një zgjidhje gjellësh dhe rregullimet optimale për to. Ne do të ju tregojmë, se cila mënyrë e nxehtësie dhe temperaturë është më e përshtatshme për gjellën tuaj. Do të merrni të dhëna për pajisje të përshtatshme dhe se në cilën lartësi do të duhet të futen. Do të merrni këshilla për enë dhe për përgatitje.

Udhëzime

- Vlerat në tabela vlejné gjithmonë për futje në hapësirën për zierje të ftohtë dhe të zbrazët. Paranxehni vetëm nëse është dhënë në tabela. Pajisjen e shtroni me letër për pjekje tek pas paranxehjes.
- Të dhënat kohore në tabela janë vlera orientuese. Ato varen nga kualiteti dhe nga cilësia e ushqimeve.
- Përdorni pajisjen e bashkëdërguar. Pajisjet plotësuese i gjeni si pajisje të veçanta në shitore të specializuara ose në shërbimin e klientëve. Para përdorimit nxirrni pajisjet dhe enët e panevojshme nga hapësira për zierje.
- Përdorni gjithmonë një leckë mbrojtëse, kur nga hapësira për zierje të nxirrni pajisje ose enë të nxehta.

Ëmbëlsirat dhe biskotat

Kallëpe për pjekje

Më të përshtatshëm janë kallëpet nga metali.

Te përdorimi i kallëpeve për pjekje nga metali me mure të holla dhe kallëpet e qelqit zgjaten kohët e pjekjes dhe ëmbëlsira nuk skuqet në mënyrë të barabartë.

Nëse dëshironi të përdorni kallëpe nga silikoni, orientohuni sipas të dhënave dhe recetave të prodhuesit. Kallëpet nga silikoni shpesh janë më të vogla se kallëpet normale. Sasitë e brumit dhe të dhënat në receta mund të devijojnë.

Tabelat

Në tabela do të gjeni mënyrën optimale të nxehtësie për ëmbëlsira të ndryshme dhe të pjekura. Temperatura dhe kohëzgjatja e pjekjes varen nga sasia dhe cilësia e brumit. Për këtë në tabela janë dhënë zona. Provojeni së pari me vlerën më të ulët. Një temperaturë e ulët jep një skuqje më të barabartë. Nëse është e nevojshme herën tjetër rregulloni më lartë.

Nëse paranxehni, kohën e pjekjes, e shkurtoni për 5 deri 10 minuta.

Informacione plotësuese do të gjeni nënkëshilla për pjekjen në aneks të tabelave.

Ëmbëlsira në kallëpe	Kallëp	Lartësia	Mënyrë e nxehtësjes	Të dhënat e temperaturës në °C	Kohëzgjatja, minuta
Ëmbëlsirë e thatë, e rëndomtë	Kallëp çmontues me fund që hiqet/ kallëp ëmbëlsirash	3		160-180	50-60
Ëmbëlsirë e thatë, e rëndomtë, e hollë	Kallëp çmontues me fund që hiqet/ kallëp ëmbëlsirash	2		150-170	60-70
Fund torte nga brumi i përzier	Kallëp për fund peme	3		140-160	20-30
Tortë frutash brumë i thjeshtë	Kallëp i lartë çmontues me fund që hiqet	3		150-170	50-60
Tortë biskotash	Kallëp çmontues	2		160-180	30-40
Fund torte nga brumi i përzier	Kallëp çmontues	1		170-190	25-35

* Ëmbëlsirat i leni në aparat rreth 20 minuta të ftohen.

Ëmbëlsira në kallëpe	Kallëp	Lartësia	Mënyrë e nxehtësisë	Të dhënat e temperaturës në °C	Kohëzgjatja, minuta
Tortë me pemë ose me gjizë, brumi i brydhët*	Kallëp çmontues	1		170-190	70-90
Ëmbëlsira me erëza*	Kallëp çmontues	1		180-200	50-60

* Ëmbëlsirat i leni në aparat rreth 20 minuta të ftohen.

Ëmbëlsira në tepsia	Pajisja	Lartësia	Mënyrë e nxehtësisë	Temperatura në °C	Kohëzgjatja në minuta
Brumë tharmi ose i përzier me shtesë të thatë	Tepsia për pjekje	2		170-190	20-30
Brumë tharmi ose i përzier me shtesë të lëngshme, pemë	Tepsia për pjekje	3		170-190	40-50
Biskota të mbështjella (paranxehni)	Tepsia për pjekje	2		190-210	15-20
Bisht tharmi me 500 g miell	Tepsia për pjekje	2		160-180	30-40
Kek me 500 g miell	Tepsia për pjekje	3		160-180	60-70
Kek me 1 kg miell	Tepsia për pjekje	3		150-170	90-100
Shtrudël, e ëmbël	Tepsia për pjekje	2		180-200	55-65
Byrek	Tepsia për pjekje	2		180-200	40-50
Pica	Tepsia për pjekje	2		220-240	25-35

Të pjekura të vogla	Pajisje	Lartësia	Mënyrë e nxehtësisë	Të dhënat e temperaturës në °C	Kohëzgjatja, minuta
Ëmbëlsira të vogla	Tepsia për pjekje	3		150-170	10-20
Të pjekura të lyera (paranxehni)	Tepsia për pjekje	3		140-150	30-40
Ëmbëlsira të vogla me bajame	Tepsia për pjekje	2		110-130	30-40
Mafishe	Tepsia për pjekje	3		80-100	100-190
Të pjekura brumi në zjarr	Tepsia për pjekje	2		200-220	30-40
Të pjekura jufkash	Tepsia për pjekje	3		190-210	20-30
Ëmbëlsira tharmi	Tepsia për pjekje	3		180-200	20-30

Bukë dhe bukëza

Të pjekja e bukës furrën e paranxehni, nëse nuk është dhënë ndryshe.

Mos derdhni asnjëherë ujë në furrën e nxehtë.

Bukë dhe bukëza	Pajisja	Lartësia	Mënyrë e nxehtësisë	Temperatura në °C	Kohëzgjatja në minuta
Bukë tharmi me 1,2 kg miell	Tepsia për pjekje	2		270 200	8 35-45
Bukë bajate me 1,2 kg miell	Tepsia për pjekje	2		270 200	8 40-50
Bukëza, p. sh. bukëza thekre (mos paranxehni)	Tepsia për pjekje	4		200-220	20-30

Këshilla për pjekje

Dëshironi të gatvani sipas recetës tuaj personale.	Orientohuni sipas biskotave të ngjashme në tabelat e pjekjes.
Kështu do ta shihni, nëse ëmbëlsira e përzier është pjekur mirë.	Rreth 10 minuta para mbarimit të kohës së pjekjes, të dhënë në recetë, ngulni një kruese dhëmbësh në pjesën më të lartë të ëmbëlsirës. Nëse në kruese nuk ngjitet më brumë, ëmbëlsira është gati.
Ëmbëlsira bie.	Herën tjetër përdorni më pak lëng ose uleni temperaturën e furrës për 10 gradë. Vini re kohët e përzierjes të dhëna në recetë.
Ëmbëlsira në mes është më e fryrë, ndërsa në skaje më ulët.	Mos i lyeni me yndyrë skajet e kallëpit çmontues. Pas pjekjes, me një thikë lironi ëmbëlsirën me kujdes.

Ëmbëlsira sipër bëhet tepër e errët.	Futni më thellë atë, zgjidhni një temperaturë më të ulët dhe piqeni ëmbëlsirën ca më gjatë.
Ëmbëlsira është tepër e thatë.	Në ëmbëlsirën e gatshme me kruesen e dhëmbëve shponi vrima të vogla. Pastaj mbi te derdhni lëng pemësh ose pije alkoolike. Herën tjetër zgjidhni temperaturë për 10 gradë më të lartë dhe shkurtoni kohën e pjekjes.
Buka ose ëmbëlsira (p. sh. ëmbëlsira me djathë) ka pamje të mirë, por brenda është e qullët (e përshkuar me vija uji).	Herën tjetër përdorni më pak lëng dhe me temperaturë më të ulët piqui ca më gjatë. Te ëmbëlsirat me shtesa të lëngshme, piqui më parë fundin. Shtrojeni me bajame ose thërrmija buke dhe pastaj qiteni shtesën për sipër. Përfillni recetat dhe kohët e pjekjes.
Të pjekurat janë të skuqura në mënyrë jo të barabartë.	Zgjidhni temperaturë ca më të ulët, atëherë të pjekurat do të skuqen në mënyrë të barabartë. Të pjekurat delikate i piqui me nxehtësinë e epërm-/të poshtëm <input type="checkbox"/> në një nivel. Dalja e letrës për pjekje jashtë tepsisë, ndikon në qarkullimin e ajrit. Letrën për pjekje e preni gjithmonë në pajtim me madhësinë e tepsisë.
Ëmbëlsira nga pemët është shumë e çelë nga poshtë.	Herën tjetër ëmbëlsirën futni një nivel më thellë.
Lëngu i pemëve po noton mbi.	Herën tjetër përdorni, nëse e keni, një tigan universal më të thellë.
Të pjekura të vogla nga brumi me tharm, gjatë pjekjes ngjiten me njëra tjetrën.	Rreth secilës të pjekur duhet të jetë një distancë prej rreth 2 cm. Kështu ka mjaft vend që të pjekurat të fryhen mirë dhe të skuqen nga të gjitha anët.
Gjatë pjekjes së ëmbëlsirave të lëngshme formohet ujë i kondensuar.	Gjatë pjekjes mund të formohet avull uji. Ai largohet nëpërmjet derës. Avulli i ujit mund të ngjitet në fushën shërbyese ose në ballinat e mobilieve të afërta dhe të pikoj si ijë i kondensuar. Kjo është fizikisht e kushhtëzuar.

Mish, shpezë, peshk

Enë

Mund të përdorni çdo enë rezistente ndaj temperaturës. Për rosto të mëdha është e përshtatshme gjithashtu dhe tepsia për pjekje.

Më i përshtatshëm është ena nga qelqi. Kapaku duhet të përputhet me enën dhe të mbyllet mirë.

Nëse përdorni enë të emaluara, shtoni më tepër masë të lëngshme.

Për enët nga çeliku skuqja nuk do të jetë shumë e fortë dhe mishi mund të jetë zierr më pak. Zgjatni kohët e zierjes.

Të dhënat në tabelat:

Enë pa kapak = çelë

Enë me kapak = mbuluar

Enën vendosni për herë në mes të rostos.

Enët e nxehta nga qelqi vendosni mbi mbrojtës mbi tavolinë. Nëse sipërfaqja është e lagur ose e ftohtë, qelqi mund të pëlçet.

Skuqja

Mishit pa dhjam shtoni edhe pak ujë brenda. Fundi i enës duhet të jetë ½ cm afërsisht i mbushur.

Mishit që piqet me avull shtoni ujë brenda në enë. Fundi i enës duhet të jetë 1 - 2 cm i mbuluar.

Sasia e lëngut varet nga lloji i mishit dhe nga materiali i enës. Nëse e përgatitni mishin në tavë të emajluar, nevoitet pak më tepër lëng, se sa në enë qelqi.

Enët nga çeliku janë kushtimisht të përshtatshme. Mishi zihet ngadalë dhe skuqet më pak. Përdorni temperaturë më të madhe dhe/ose leni të zihet më gjatë.

Udhëzime për pjekje në skarë

Gjatë pjekjes me skarë paraxehni rreth 3 minuta, para se në hapësirën për zierje ta futni ushqimin për skarë.

Piqni në skarë gjithmonë me furrë të mbyllur.

Merrni mundësisht copa me trashësi të njëjtë mishi. Në këtë mënyrë ato skuqen në mënyrë të barabartë dhe ngelin bukur të lëngshme.

Copat e mishit i ktheni pas ⅔ kohës së zierjes.

Stekat i kripi tek pasi të jenë pjekur në skarë.

Vendosni copat e mishit drejtpërdrejtë në skarë. Një copë e vetme mishi bëhet më e mirë nëse e vendosni në mes të skarës.

Pastaj tepsinë për pjekje e futni në lartësinë 1. Lëngu i mishit do të mblidhet në tepsi dhe kështu furra ngel e pastër.

Tepsinë për pjekje ose tiganin universal gjatë pjekjes me skarë mos e futni në lartësinë 4 ose 5. Në saje të nxehtësisë së fortë ata mund të shtrembërohen dhe gjatë nxjerrjes mund ta dëmtojë hapësirën për zierje.

Trupi nxehtë i skarës herë ndizet e herë fiket. Kjo është normale. Sa shpesh do të ndodh kjo, varet nga shkalla e rregulluar e skarës.

Mishi

Në mes të kohës së paraparë copat e mishit që piqen duhet rrotulluar në anën tjetër.

Kur të ketë mbaruar pjekja, duhet edhe 10 minuta të ngel mishi në furrë të shuar, ashtu e mbyllur. Kështu lëngu i mishit do të shpërndahet më mirë.

Mishin e lopës pas pjekjes mbeshitjellni me letër alumini dhe leni rreth 10 minuta në furrë.

Preni roston e derit me lëkurë lëkurën në formë kryqi dhe së pari vendoni roston nga lëkura në enë.

Mishi	Pesha	Pajisje dhe enë	Lartësia	Mënyrë e nxehtës	Të dhënat e temperaturës në °C, shkalla e skarës	Kohëzgjatja, minuta
Mish gjedhi						
Të skuqura gjedhi	1,0 kg	mbyllur	2		200-220	120
	1,5 kg		2		190-210	140
	2,0 kg		2		180-200	160
Filet gjedhi, rozë	1,0 kg	hapur	2		210-230	70
	1,5 kg		2		200-220	80
Bifteq, rozë	1,0 kg	hapur	1		210-230	50
Stekë, rozë 3 cm		Skarë	5		3	15
Mish viçi						
Të skuqura viçi	1,0 kg	hapur	2		190-210	100
	2,0 kg		2		170-190	120
Mish derri						
pa lëkurë (p.sh. . qafë)	1,0 kg	hapur	1		200-220	100
	1,5 kg		1		190-210	140
	2,0 kg		1		180-200	160
me lëkurë (p.sh. shpatulla)	1,0 kg	hapur	1		200-220	120
	1,5 kg		1		190-210	150
	2,0 kg		1		180-200	180
Brinjë derri me koc	1,0 kg	mbyllur	2		210-230	70
Mish qengji						
Kofsha qengji pa koc, medium	1,5 kg	hapur	1		150-170	120
Mish i bluar						
Të skuqura nga mishi i bluar	rreth 500 g	hapur	1		170-190	70
Salsiçe						
Salsiçe		Skarë	4		3	15

Shpend

Të dhënat në tabelë mbi peshën janë të dhëna për shpezë, të pambushura, të gatshme për pjekje.

Së pari vendosni shpezën me pjesën e gjoksit për teposhtë në rosto. Kthejeni pas $\frac{2}{3}$ kohës së caktuar.

Copat për pjekje, si rollada për pjekje nga pula e detit, ktheni pas si të ketë kaluar gjysma e kohës së caktuar. Pjesë shpezësh $\frac{2}{3}$ ktheni pas kohës së caktuar.

Shponi lëkurën ndër krahët te rosat dhe patat. Kështu do të rrjedh yndyra.

Shpeza do të bëhet e bridhët dhe e skuqur mirë, nëse kah fundi i kohës së caktuar të pjekjes e lyeni me puter, ujë të kripiur ose me lëng portokalli.

Nëse pjekni direkt mbi rosto, Tepsinë për pjekje vendosni në nivelin 1. Lëngu i mishit do të grumbullohet në në tepsi dhe kështu ngel furra e pastër.

Shpend	Pesha	Enë	Lartësia	Mënyrë e nxehtës	Temperatura në °C	Koha e pjekjes në minuta
Gjysma pule, 1 deri 4 copa	secila nga 400 g	Skara	2		200-220	40-50
Pulë e transhuar	secila nga 250 g	Skara	2		200-220	30-40
Pula, të tëra, prej 1 deri 4 njësi	secila nga 1,0 kg	Skara	2		190-210	50-80
Rosë	1,7 kg	Skara	2		180-200	90-100
Patë	3,0 kg	Skara	2		170-190	110-130
Gjel deti i ri	3,0 kg	Skara	2		180-200	80-100
2 kofsha miske	secila nga 800 g	Skara	2		190-210	90-110

Peshk

Copat e peshkut i ktheni pas $\frac{2}{3}$ së kohës së skarës.

Peshku i tërë nuk duhet të kthehet. Peshkun e tërë e futni në furrë në pozicioni noti, me pendën e kurrizit nga lartë. Nëse në

barkun e peshkut futni një patate të prerë ose një enë të qëndrueshme në furrë e bën atë më stabil.

Nëse piqni direkt mbi skarë, tepsinë për pjekje e futni në mënyrë plotësuese në lartësinë 1 . Lëngu do të mblihet dhe furra do të ngelë e pastër.

Peshk	Pesha	Pajisje dhe enë	Lartësia	Mënyrë e nxehtjes	Të dhënat e temperaturës në °C, shkalla e skarës	Kohëzgjatja, minuta
Peshk, i tërë	nga 300 g	Skarë	2		3	20-25
	1,0 kg	Skarë	2		180-200	45-50
	1,5 kg	Skarë	2		170-190	50-60
Filet peshku, 3 cm		Skarë	3		2	20-25

Këshilla për pjekje dhe tiganisje

Për peshën e rostos në tabelë nuk ka të dhëna. Zgjidhni të dhënat sipas peshës më të ulët të radhës dhe zgjasni kohën.

